



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Laç, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

*Shtojca 13*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT 2  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 24.01.2024

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “**COMPANY RIVIERA 2008**” SHPK, **Adresa:** Tirane Kamez KAMEZ Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, ne zone kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/35.

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Punë (Prokurim me mjete elektronike).

**Numri i procedurës / referenca:** **REF-88954-11-23-2023**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Asfaltim i rrugës Likaj – Demokracia, Lac”.

**Fondi limit:** **11,447,856** (njëmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 2 muaj.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.96, datë 30.11.2023.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

**Me anë të kësaj ju informojmë se, Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik “**COMPANY RIVIERA 2008**” SHPK, me numër NIPTI **K81716011V**.

**Vlera e ofertuar:** **7,383,353.75** (shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“Progres Shkodra” SHPK** me numër NIPTI **M17324001D & “SMO VATAKSI” SHPK** me numër NIPTI **L47022001J**.  
**Vlera e ofertuar: 7,956,300** (shtatë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik **“S.M.O.UNION” SHPK**, me numër NIPTI **J66902042Q**.  
**Vlera e ofertuar: 8,228,550** (tetë milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **“XHAST SHPK” SHPK**, me numër NIPTI **K12512837I**.  
**Vlera e ofertuar: 9,574,666.81** (nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e një) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **“SARK” SHPK**, me numër NIPTI **K52531415H**.  
**Vlera e ofertuar: 10,040,908** (dhjetë milion e dyzet mijë e nëntëqind e tetë) lekë **pa TVSH**.
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“OUEN” SHPK** me numër NIPTI **K17529215O & “SHPRESA - AL” SHPK** me numër NIPTI **K31321021N**.  
**Vlera e ofertuar: 10,079,910.8** (dhjetë milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dhjetë pikë tetë) lekë **pa TVSH**.
7. Operatori ekonomik **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **K82230002K**.  
**Vlera e ofertuar: 11,005,118** (njëmbëdhjetë milion e pesë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë **pa TVSH**.

**Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“Progres Shkodra” SHPK** me numër NIPTI **M17324001D & “SMO VATAKSI” SHPK** me numër NIPTI **L47022001J**.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ....**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

**I. BOE nuk plotëson pikën 2.3.1/3 të DST (për punë të ngjashme), si më poshtë:**

*2.3.1/3 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

**KVO konstatoi se:** Konkretisht OE “Progres Shkodra” SHPK (i cili ka marrë përsipër kryerjen e 90% të punimeve), nuk plotëson kriterin e mësipërm për punë të ngjashme.

Sqarojmë se OE “Progres Shkodra” SHPK ka paraqitur në SPE për punë të ngjashme vetëm për një objekt (1 folder) si Nënkontraktor.

Pra OE “Progres Shkodra” SHPK, ka lidhur kontratë nënkontraktimi me BOE “S.M.O.UNION” & “CURRI”, me Investitor (Autoriteti Kontraktor FSHZH).

Autoriteti Kontraktor Bashkia Kurbin, ka kërkuar në DST në pikën 2.3.1/3 që: *Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

Për sa më sipër, OE “Progres Shkodra” SHPK, nuk ka paraqitur kontratën bazë të lidhur ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor (FSHZH). Gjithashtu nuk ka paraqitur Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor (FSHZH).

**II. Gjithashtu BOE nuk plotëson pikën 2.3.6/a të DST, si më poshtë:**

*2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit, si më poshtë:*

*A. Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontrate punës të vlefshme, deshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi /IQT të vlefshme si dhe duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise te paktën muajn e fundit të deklaruar:*

- Hidraulike 1
- Elektracist 1

**KVO konstatoi se:** BOE, nuk plotëson kriterin e mësipërm, pikën 2.3.6/a (Për 1 hidraulik dhe 1 elektrikist).

Sqarojmë se KVO pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që secili OE ka paraqitur në SPE, konstatoi se BOE nuk ka deklaruar punonjës (Për 1 hidraulik dhe 1 elektrikist), për të plotësuar pikën 2.3.6/a, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

**2. Operatori ekonomik “XHAŠT SHPK” SHPK, me numër NIPTI K12512837I.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit .....**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke**

kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

**I. OE nuk plotëson pikën 2.3.3/2.3.4 të DST (për 1 Inxhinier Ndertimi), si më poshtë:**

**KVO konstatoi se:** OE “XHAŠT SHPK” SHPK, nuk plotëson kriteret e kërkuara në DST (për 1 Inxhinier Ndertimi).

Sqarojmë se AK në DST tek pika 2.3.3 ka kërkuar: *1 (një) Inxhinier Ndertimi*, si dhe tek pika 2.3.4 ka kërkuar: *1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili infastruktura transport)*. Pra AK në DST ka kërkuar në total 2 Inxhinierë Ndertimi.

Ndërsa operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar vetëm 1 (një) Inxhinier Ndertimi (znj. Lavdie Mici).

Sa më sipër, duke qenë se AK në DST ka kërkuar 2 Inxhinierë Ndertimi, ndërsa OE ka deklaruar vetëm 1 Inxhinier Ndertimi, **KVO e skualifikon pasi nuk plotëson kriteret e kërkuara në DST për 1 Inxhinier Ndertimi.**

**II. OE nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, si më poshtë:**

*2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>15</i>	<i>Autobetoniere</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

**KVO konstatoi se:** OE “XHAŠT SHPK” SHPK, nuk plotëson kriteret e kërkuara në DST (për 1 Autobetoniere).

Sqarojmë se AK në DST tek pika 2.3.9 ka kërkuar: *1 (një) Autobetoniere* (Autobetonieria është mjetet me goma që shënohet në regjistra publikë), pra është mjet që do lëvizë në rrugë kombëtare dhe duhet me dokumentacion.

Ndërsa operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar vetëm 1 Autobetoniere me Akt Zhdoganimi (mjet pa targa), e cila nuk përmbush kriteret që AK ka kërkuar në DST.

**3. Operatori ekonomik “SARK” SHPK, me numër NIPTI K52531415H.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit .....**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

**I. OE nuk plotëson pikën 2.3.4/d të DST, si më poshtë:**

**2.3.4.** *Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:*

**d.Puntore te thjeshte (te ndryshem) 10 (dhjetë)** per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi mujin e fundit.

*Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**KVO konstatoi se:** OE “SARK” SHPK, nuk plotëson kriterin e mësipërm (Për **Puntore te thjeshte (te ndryshem) 10 (dhjetë)**). Sqarojmë se KVO pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që OE ka paraqitur në SPE, konstatoi se ky OE nuk ka deklaruar asnjë punonjës (**Puntore te thjeshte (te ndryshem) 10 (dhjetë)**), që plotëson pikën 2.3.4/d, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

**II. Gjithashtu OE nuk plotëson pikën 2.3.8 të DST, si më poshtë:**

**2.3.8** *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 25 (njëzet e pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për periudhën Gusht - Shtator – Tetor- 2023, e vertetuar kjo me:*

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

*Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**KVO konstatoi se:** OE “SARK” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk përmbush numrin e punonjësve me kohë të plotë (22 ditë).

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST që: *operatori ekonomik duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 25 (njëzet e pesë) persona, ..... për periudhën Gusht - Shtator –Tetor- 2023 .....etj.*

Sqarojmë se pas verifikimit të listëpagesave që OE ka paraqitur në SPE, KVO konstatoi se:

- Në muajn Gusht 2023 ka total 37 punonjës, nga të cilët 10 punonjës i ka me kohë të plotë (22 ditë), 4 punonjës (me 5 ditë), 3 punonjës (me 4 ditë) dhe 20 punonjës (me 2-3 ditë) pune.

- Në muajn Shtator 2023 ka total 30 punonjës, nga të cilët 10 punonjës i ka me kohë të plotë (22 ditë), 4 punonjës (me 5 ditë), 4 punonjës (me 4 ditë) dhe 12 punonjës (me 3 ditë) pune.
- Në muajn Tetor 2023 ka total 18 punonjës, nga të cilët 10 punonjës i ka me kohë të plotë (22 ditë), 4 punonjës (me 5 ditë), 2 punonjës (me 4 ditë) dhe 2 punonjës (me 3 ditë) pune.

Sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ka mesatarisht 10 punonjës me kohë të plotë nga 25 (njëzet e pesë) që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST.

Për sa më sipër KVO mendon se ky operator ekonomik nuk ka një staf të specializuar të punësuar me kohë të plotë dhe nuk na bind se e kryen punën me cilësi dhe brenda afateve ligjore. Gjithashtu mendojmë se mos pasja e një stafi me kohë të plotë pune nuk garanton zbatimin e kontrates.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“COMPANY RIVIERA 2008” SHPK**, me adresë: Tirane Kamez KAMEZ Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, ne zone kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/35, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **7,383,353.75** (shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **8,228,550** (tetë milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

**JO (Nuk ka patur)**

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**  
**Majlinda CARA**